



**NGRITJA  
E ZËRIT**

**Tel:** 044 195-113  
044 633-325  
**Adresa:** Rruga e UÇK-së,  
Skenderaj  
**Email:** info@ngritjaezerit.org  
**Web:** www.ngritjaezerit.org

## GJYKATES KOMUNALE NE GJAKOVË

**PADITES:** Hanife Ramadani nga fshati Burojë, 41000 Skenderaj, Republika e Kosovës

**E PADITUR:** REPUBLIKA E SERBISË –Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës  
nr.11 11000 Beograd

### **PADI PER KOMPENZIM DEMI**

**Propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale** ( sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

**Objekt kontesti :** Kompensimi dëmit

**Vlera e kontestit :** 1076000€

1.) Padiësja është bashkëshortja e te ndjerit Hazir Ramadani, i cili gjatë rrugëtimit ne kolone ne drejtim te Shqiperisë, dhunshëm është ndar nga familja fshatin Bec te Gjakovës dhe është pushkatuar nga ana e forcave ushtarako-policore serbe. Pas lufte është gjetur në një varr masiv, ashtu qe pas identifikimit i njejtë është rivarrosur ne varrezat e fshatit në Burojë të Skenderajt. I ndjeri Hazir Ramadani pas vdekjes ka lënë bashkëshorten Hanife Ramadani ,djemt; Sherif Ramadani 1981, Fisnik Ramadani 1985 dhe Arjanit Ramadani 1994 si dhe vajzën Arbulena Ramadani 1987.

Provë : - Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , e dt. 15.01.2009 , nr. 580 -39-

- Vërtetimi nga OJQ “Pengu i Lirisë” nr.667/08 te datës 29.12.2008

- Vërtetimi i DSHMS 580-236 i dt. 19.04.2010

- Deklarata për bashkësinë familjare nenë numrin rendor 035/095 e dt.30.12/09

2.) Padijsja se bashku me femijet e saj; vajzën Arbulena dhe djemt; Sherifin, Fisnikin dhe Arjanitin, është pasardhëse juridike e sendeve te luajtshme dhe te pa luajtshme te cilat janë krijuar nga puna e përbashkët dhe trashëgimia , kjo patundshmëri përbehet prej shtëpisë me sipërfaqe prej 108 m<sup>2</sup> , dëmtim te kategorisë se V , me interier shtëpiak duke e përfshire tekniken e bardhe me pajisjet përkatëse në sallon dhe mobilierin e dhomave te gjumit .

Provë :

Vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit nr.325-129 i dt.30.12.2008

Certifikata mbi te drejatat e pronës së paluajtshme

3.) Viktima nga forcat ushtarako policore serbe të udhëhequra direkt prej qeverisë se Serbisë e cila ka kryer veprime gjenocidiale , krime kundër njerëzimit ka humbur bashkëshortin , i është shkatërruar pasuria , është detyruar ta braktis vendbanimin se bashku me fëmijët ne kohë zgjatje prej një viti e një muaj muaj ka qen e strehuar nga

familjaret në Mirushë-Gjakovë 3 muaj, Mitrovicë 4 muaj, në Kopiliq 3 muaj dhe në Shqipëri 3 muaj , gjithsejt një vit e një muaj si ne aplikacion.

Provë : Kërkesa për kompensimin e dëmeve të luftës , e dt.15.01.2009, nr. 580 - 39

Dëgjimi i paditësës fëmijëve të saj si dhe provave të tjera të cilat paditësja do të prezantoj në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në rast nevojë të caktohet edhe eksperti përkatës .

4.) Të drejtën për kompensim padisja e bazon në nenin 185 të LMD ( G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78 ) në lidhje me nenin 180.1 të të njëjtit Ligj , me të cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë të personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura ka qenë e obliguar të pengoj aktet e vrasjes , dhunës, terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes së pasurisë së paditësës .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut ( neni 1 Protokollin nr. 1 , neni 2 dhe protokollin nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14 ) .

Paditësja propozon që kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor të çështjes , t'i shfrytëzoj informatat e dhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bjen këtë :

#### AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesa padisja e paditësës Hanife Ramadani, e gjinisë \_\_\_\_\_ me vendbanim në f.sh. Burojë , 41000 Skenderajt Republika e Kosovës në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Republika e Serbisë - Qeveria e R.S. si pasardhëse juridike e Qeverisë së më parshme që në emër të të njëjtës të kompensojë demin material dhe jo material paditësës Bahtie Nimani, nga f.sh. Qubrel, me vendbanim në Qubrel, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumen prej 800.000 € për bashkëshortin e vrarë
- shumen prej 52 000 € për dhembjen shpirtërore dhe të munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi në qiell të hapur dhe shtëpi të huaja
- shumen prej 50 000 € për shkak të pamundësuarit e krenimit të festave fetare në shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes së kontaktit me farefis dhe të afërmit
- shumen prej 162 000 € për shtëpinë e djegur dhe të shkatërruar tërësisht, për teknikën e bardhe në sallën dhe mobilerin e dhomave të gjumit.
- shumën prej 12 000 € për traktor, rimorkio dhe pllugj të
- shumën prej ----- për pensionin e ndalur nga viti 1998- 03.04.199
- shumen prej ----- € për pamundësimin e shfrytëzimit të tokës bujqësore për tri vite

të gjitha këto shuma me kamat ligjore që nga dita e ngritjes së padisë e deri në ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm .

Pala e paditur të paguaj shpenzimet procedurale të kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm ,

1.) të bihet :

### AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit të paditësit në tërësi për çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marrë parasysh gjendjen e vështirë ekonomike të paditësit në kuptim të nenit 7 Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 të Ligjit Nr. 03/L-006 .  
Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Hanife Ramadani



Shtojcë :

1. Kërkesa për kompensimin e dëmeve të luftës , e datës 15.01.2009 , nr. 580 -39
2. Deklarata për bashkësinë familjare në numrin rendor 035/20386 e dt.26 dhjetor 2008
3. Vërtetimi nga OJQ "Pengu i Lirisë" nr.667/08 të datës 29.12.2008
- 4 Vërtetimi i DSHMS 580-236 i dt. 19.04.2010
5. Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
6. Vërtetimi I Drejtorisë së Urbanizmit nr.325-129 i dt.30.12.2008
7. 4 kopje të padisë